



www.legjislacioni.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 27

Tiranë – E hënë, 3 tetor 2016

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Kërkesë e Ministrisë së së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5405, datë 22.9.2016	Shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Asistencë teknike për hedhjen e të dhënave të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar në arkivin elektronik”.....	3
Kërkesë e Ministrisë së së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5540, datë 29.9.2016	Shprehje interesi për shërbime konsulence për “Asistencë teknike për zbatimin e aktiviteteve të fushatës së komunikimit për reformën e NE (faza e dytë)”.....	4



**PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË  
ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)**

Tiranë, 21.9.2016

**KËRKESË**

Nr. 5405, datë 22.9.2016

**PËR SHPREHJE INTERESI,  
SHËRBIME KONSULENCE PËR  
ASISTENCË TEKNIKE PËR HEDHJEN E  
TË DHËNAVE TË PËRFITUESVE TË  
PAGESAVE TË AFTËSISË SË KUFIZUAR  
NË ARKIVIN ELEKTRONIK  
- REF.NO. SAMP/CS/CQ/03-2015**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës  
Sociale (SAMP)*

*Hua nr. 8141-AL*

*Nr. i identifikimit të projektit: P122233*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbimi) përfshin: **“Asistencë teknike për hedhjen e të dhënave të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar në arkivin elektronik”**.

Qëllimi i kësaj detyre është që të mundësojë regjistrimin e dosjeve ekzistuese për çdo person me aftësi të kufizuar, skanimin dhe ngarkimin e dokumenteve që përmbajnë dosjet, kërkimi dhe aksesimi në dokumentet e këtyre dosjeve, lidhja e dosjeve ekzistuese me dokumentet e reja të personave me aftësi të kufizuara.

Një firmë konsulente, me mbështetje *backup*-i dhe burime njerëzore dhe logjistike të përshtatshme, është e nevojshme që të asistojë MMSR-në në hedhjen e të dhënave të përfituesve ekzistues të PAK-së, të cilët trajtohen nga MMSR-ja në arkivin elektronik, sipas fushave përkatëse.

Në veçanti, konsulenti do të ofrojë mbështetje teknike pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror për të siguruar hedhjen në fushat përkatëse të arkivit elektronik të të gjitha dokumenteve të dosjeve ekzistuese, për çdo person me aftësi të kufizuara që trajtohet nga MMSR-ja, përmes skanimit të dokumenteve, në përputhje me një plan veprimi të miratuar paraprakisht.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

1. Të marrë në dorëzim me procesverbal të gjitha dosjet e përfituesve ekzistues të PAK-së nga drejtoria rajonale përkatëse e shërbimit social shtetëror;

2. Të sigurojë se informacioni është skanuar dhe regjistruar si duhet dhe pa gabime gjatë operacioneve të futjes së të dhënave në sistem;

3. Të sigurojë saktësinë e të dhënave që hyjnë në arkivin elektronik për çdo dosje;

4. Të sigurojë futjen e të dhënave në fushën përkatëse;

5. Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

6. Pas skanimit dhe para se të lidhen të gjitha dokumentet, duhet të kontrollohen dhe të sigurohet që janë vendosur në të njëjtën renditje si përpara skanimin;

7. Do të punojë nën drejtimin e stafit përgjegjës të drejtorisë rajonale përkatëse të shërbimit social, i cili do të vërtetojë dhe hedhjen e të gjitha të dhënave në arkiv, përpara pagesës përfundimtare;

8. Dorëzimi me procesverbal (letër pranimi) të drejtorisë rajonale të të gjitha proceseve të përmendura pas përfundimit të shërbimit.

Konsulenca do të kryhet nga një firmë lokale konsulente me përvojë të dëshmuar në hedhjen e të dhënave në projekte të ngjashme në institucionet e administratës publike ose ndërmarrjet e ngjashme. Ekipi do të përbëhet nga një drejtues ekipi/menaxher, mbikëqyrësit dhe operatorët. Drejtuesi i ekipit duhet të jetë me shumë përvojë në drejtimin e projekteve të ngjashme, zbatimin e procedurave të regjistrimit të të dhënave, dhe të jetë në gjendje për të ofruar në fund të shërbimit bazën e përfunduar të të dhënave për përfituesit e PAK-së. Drejtuesi i ekipit duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë përkatëse profesionale në ato fusha.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë/Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT) ftojnë të gjitha kompanitë konsulente të pranueshme (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.



Kriteret e shortlistimit dhe të vlerësimit janë:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| 1. Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit | 10 pikë         |
| 2. Numri i shërbimeve/kontratave të kryera gjatë tri viteve të fundit         | 10 pikë         |
| 3. Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimi i ekspertëve kryesorë           | 20 pikë         |
| 4. Eksperienca dhe kualifikime të ngjashme me këtë shërbim të stafit kryesor  | 50 pikë         |
| 5. Numri i viteve të personelit kryesor në firmë                              | 10 pikë         |
| <b>TOTAL</b>  | <b>100 pikë</b> |

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & Grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (Udhëzuesi i konsulentëve) - version i janarit të 2011-s.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të forcuar kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është: “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” – CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore, për përzgjedhjen e punësimit e konsulentëve (botimi i janarit 2011). Kohëzgjatja e shërbimit do të jetë brenda një periudhe 3-mujore.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **5 tetor 2016**.

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**  
**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**  
**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë – kati 1**  
**Rruga e Kavajës, nr. 53, Tirana, Albania**  
**Në vëmendje të znj. Suzana Papadhropulli**

## PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)

Tiranë, më 27.9.2016

### KËRKESË

Nr. 5540, datë 29.9.2016

### PËR SHPREHJE INTERESI SHËRBIME KONSULENCE PËR “ASISTENCË TEKNIKE PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË FUSHATËS SË KOMUNIKIMIT PËR REFORMËN E NE (FAZA E DYTË)” REF. NO. SAMP/CS/CQ/12–2016

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)*

*Hua No.: 8141- AL*

*Nr. i identifikimit të Projektit. P122233*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulentëve (“Shërbim”) përfshin lokale **“Asistencë teknike për zbatimin e aktiviteteve të fushatës së komunikimit për reformën e NE (faza e dytë)”**.

Në bashkëpunim të ngushtë me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Departamentit të Mbrojtjes Sociale dhe të Integruar të Shërbimeve brenda MMSR-së (e cila është agjencia zbatuese për SAMP-in), ofruesi lokal/kontraktori do të jetë përgjegjës për sigurimin pjesën logjistike të aktiviteteve të komunikimit të propozuara nga stafi i Ministrisë për promovimin e vetëdijes, të kuptuarit dhe pranimin e reformave në programin e ndihmës ekonomike (NE).

Zbatimi i aktiviteteve të komunikimit do të sjellë një sërë aktivitetesh, duke filluar nga prodhimi i materialeve të informacionit (të tilla si: spote dhe sloganin, materiale të shtypura etj.) deri në organizimin e ngjarjeve publike (takime të hapura etj.).

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton të gjitha kompanitë e konsulentëve legjitime (“Konsulente”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë



kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Konsulenti i suksesshëm duhet të ketë demonstruar përvojë në fushën e zbatimit të aktiviteteve të komunikimit. Konsulenti duhet të tregojë se disponon kapacitetet e mëposhtme:

- Demonstrojë aftësitë në marketingun social;
- Përvojë të gjerë në fushën e komunikimit, duke përfshirë reklama, marrëdhëniet me publikun, mediat, fushatat, marketing social dhe aktiviteteve të lidhura me to në Shqipëri (përvojë në fushatë qeveritare të komunikimit e preferuar);

- Njohuri të fundit dhe përvojë në fushën e mediave të reja dhe teknologjive të komunikimit/produkteve të bazuara në *web* dhe se si t'i menaxhojë ato në mënyrë profesionale;

- Aftësia për të planifikuar, dizenuar dhe zhvilluar produkte të informacionit (të tilla si: materiale audiovizuale dhe të shtypura, materiale të fushatës, produkteve bazuar në *web* etj.) dhe implementimin e aktiviteteve të komunikimit (të tilla si: *workshop*, seminare, takime, fokus grupet e diskutimit etj.);

- Gjykimi i mirë dhe njohuri dhe përvojë në çështjet socio-politike, kulturore dhe aktuale në Shqipëri, si dhe në rajon.

Kompania duhet të ketë stafin e mëposhtëm në dispozicion për këtë detyrë, si udhëheqës Ekipi, projektues profesional, ekspert për prodhimin e ngjarjeve vizuale, ekspert për dizajnimin e web, të gjithë kërkohen me përvojë të gjerë profesionale në tregun lokal ose atë rajonal.

Kriteret e shortlistimit janë:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| 1. Eksperienca specifike e firmës në fushën e detyrës                             | 40 pikë         |
| 2. Numri i shërbimeve të ngjashme/kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit | 30 pikë         |
| 3. Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimi i stafit kryesor                    | 30 pikë         |
| <b>TOTALI</b>   | <b>100 pikë</b> |

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së & Grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore* (“Udhëzuesi i Konsulencës”) – version i janarit të 2011-s.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një “*joint venture*” apo në formën e nënkontraktimit për të rritur kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” – CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimin e konsulentëve (botimi i janarit 2011).

Konsulenti pritët të fillojë shërbimin në tetor 2016 dhe afati i shërbimit përlloritet rreth 8 javë.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premtën.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **10 tetor 2016**.

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**  
**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**

**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**  
**“Rruga e Kavajës”, nr. 53, Tirana, ALBANIA**

**Në vëmendje të: Znj. Suzana Papadhopulli**  
**e-mail: [samp.papadhopulli@gmail.com](mailto:samp.papadhopulli@gmail.com)**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2016**